



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
**OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN**

---

**AD.GJTH.GJL.nr.10/23**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**, përmes kryetarit të gjykatës Venhar Salihu, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, duke vepruar sipas ankesës së datës 24.10.2023 të parashtruar nga ankuesja D [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], avokate nga Prishtina, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit B [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, më datë 25.10.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET e pabazuar** ankesa e parashtruar nga ankuesja D [REDAKTUAR] K [REDAKTUAR], avokate nga Prishtina, e datës 24.10.2023, për iniciimin e procedurës disiplinore konform Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, të paraqitur ndaj gjyqtarit B [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] - gjyqtar në Divizionin Civil të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë.

**A r s y e t i m**

Më datë 24.10.2023, avokatja Donikë Krasniqi nga Prishtina, ka parashtruar ankesë lidhur me lëndën kundërvajtëse K.nr.103/2022, sipas së cilës, avokatja përfaqëson të pandehurin Z [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] si person përgjegjës i kompanisë "V [REDAKTUAR]", Petrol, N.T.P.

Në ankesë, pretendimet e avokates konsistojnë në faktin e thirrjes së të pandehurit Z [REDAKTUAR] M [REDAKTUAR] për ekzekutim të dënimit me gjobë sipas vendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, K.nr.103/22 të datës 05.06.2023, ende pa u pranuar vendimi i gjykatës së shkallës së dytë lidhur me ankesën e datës 12.10.2023; në faktin e dorëzimit të ankesës përmes postës rekomandë më datë 05.06.2023, ndërsa nga gjyqtari i çështjes është marrë si datë e ankesës, data e protokoluar në gjykatë më 08.06.2023; dhe në faktin e shkeljes së ligjit me rastin e dënimit me gjobë në shumë prej 10,00.00 euro, si dënim i ndaluar sipas Ligjit për Shoqëri Tregtare dhe Ligjit për Naftë dhe Derivate të saj. Nga këto fakte ka pretenduar se gjyqtari B [REDAKTUAR] A [REDAKTUAR] është subjektiv në trajtimin e çështjes.

Ka shtjelluar kronologjinë e lëndës kundërvajtëse, ashtu që për të njëjtën është vendosur paraprakisht sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Dega në Novobërdë, K.nr.103/22 të datës 01.08.2022, mirëpo është kthyer në rigjykim sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, KA.nr.359/2022 të datës 13.10.2022. Në procedurën e rigjykimit, është vendosur përsëri me vendim

meritor, sipas Aktgjykimit K.nr.103/2022 të datës 05.06.2023, ndërsa ankesa për këtë vendim është hedhë poshtë nga gjykata e shkallës së parë dhe i njëjti vendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit të Kosovës, me Aktvendimin KA.nr.293/2023 të datës 25.09.2023.

Nga kjo rrjedhë e çështjes, shihet se vendimi ka marrë formën e prerë dhe i pandehuri është ftuar për ekzekutimin e dënimit, pasi që vendimi është bërë i formës së prerë.

Kryetari i gjykatës, pas pranimit të ankesës dhe analizimit të pretendimeve të të njëjtës, ka vlerësuar se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndonjë shkelje të mundshme disiplinore, prandaj lidhur me këtë çështje nuk ka kërkuar nga gjyqtari që të deklarohet rreth pretendimeve të palës ankuese, ngase sipas vlerësimit të kryetarit të kësaj gjykate, ankesa e palës ankuese e dt. 24.10.2023, është e pabazuar dhe pretendimet e të njëjtës nuk e justifikojnë iniciimin e procedurës disiplinore.

Deri te një përfundim i tillë kryetari i gjykatës erdhi pas vlerësimit dhe analizimit me shumë kujdes të pretendimeve të palës ankuese të paraqitura në ankesën e saj, ku sipas kryetarit të kësaj gjykate veprimet e gjyqtarit B. A. gjatë zbatimit të procedurës kundërvajtëse, nuk mund të konsiderohen si veprime joprofesionale dhe që janë në kundërshtim me etikën e gjyqtarit dhe si të tilla nuk mund të cilësohen si shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit, ngase gjyqtari mandatin e tij gjyqësor e ushtron në mënyrë të pavarur dhe profesionale, duke i vlerësuar në mënyrë individuale të gjitha faktet dhe provat që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm dhe në mënyrë meritore, ndërsa pretendimet lidhur me mënyrën e vendosjes i përkasin mjeteve juridike për atakim të atij vendimi, e jo iniciimit të procedurës disiplinore. Ankuesja ka të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike ligjore për të kundërshtuar një vendim që e konsideron jo të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj pretendimet e së njëjtës janë të orientuara në këtë drejtim dhe nuk mund të prodhojnë efekt në procedurë disiplinore.

Andaj kryetari i kësaj gjykate, konform nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, ka gjetur se ankesa e ankuses Donikë Krasniqi, avokate nga Prishtina, e datës 23.10.2023, është e pabazuar dhe për të njëjtën ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kryetari i Gjykatës,

Venhar Salihu



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vendimi duhet i dorëzohet:

1. Gjyqtarit B. A.
2. Parashtruesit të ankesës,
3. KGJK-së
4. Dosjës së lëndës.